



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 538/4 Prot.

Tiranë, më 09.11.2016

**V E N D I M**  
**Nr. 120 datë 09.11.2016**

**Për pezullimin e hetimit administrativ filluar me**  
**Urdhërin e Verifikimit nr. 538 prot., datë 02.09.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 35, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr. 246 prot., datë 25.10.2016, dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në ecurinë disiplinore ndaj punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave , \*\*\*\*\*.

**V ë r e j s e:**

Në zbatim të Urdhërit nr. 538 prot., datë 02.09.2016, ka filluar hetimi administrativ për verifikimin e ligjshmërisë, të veprimtarisë administrative të kryer nga Komisioni i Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në nxjerrjen e aktit administrativ "Vendim i Ndërmjetëm" nr. 16763/3 prot., datë 04.07.2016, me të cilin është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës për nëpunësin \*\*\*\*\*.

Shkak për fillimin e kësaj procedure ndërmjet të tjerave është bërë një ankesë e paraqitur prej nëpunësit \*\*\*\*\* , protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me

nr. 522 prot., datë 16.08.2016, përmes së cilës pretendohet se ndaj tij, në shkelje flagrante të ligjit, është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës.

Pas shqyrtimit paraprakisht të kërkesës lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, janë njoftuar Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Departamenti i Administratës Publike, për fillimin e verifikimit të këtij informacioni. Referuar akteve administrative të dërguara nga këto institucione deri në këtë moment rezultoi e provuar se:

Në datën 30.06.2016, punonjësi \*\*\*\*\*\*, së bashku me tre specialistë të tjerë të Drejtorisë së Hetimit, janë urdhëruar të ushtrojnë kontroll mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit, në pikën doganore “*Tre Urat, Përmet*”. Gjatë kryerjes së detyrës ata konstatuan se, dy mjete me targa AA 374 DR dhe AA 259 KC, po tentonin të kryenin veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore në fushën doganore. Grupi hetimor ka informuar menjëherë sektorin e monitorimit pranë Drejtorisë Operacionale Hetimore (DOH) për rastin në fjalë, dhe ka marrë konfirmimin për ndjekjen e dy mjeteve të dyshuara, me qëllim evidentimin dhe goditjen e kontrabandës. Gjatë ndjekjes së mjeteve në anën e territorit grek, ata janë ndaluar nga policia e atij vendi, dhe më tej janë akuzuar penalisht si anëtarë dhe pjesëmarrës/bashkëpunëtorë në një organizatë të strukturuar kriminale, e cila kryente grabitje me qëllim përfitimi, si dhe mosbindje ndaj organeve policore.

Pas momentit të ndalimit, është ndërprerë komunikimi me qendrën operacionale, gjë e cila ka bërë që Drejtori i Drejtorisë Hetimore, me shkresën nr. 16763 prot., datë 01.07.2016, të njoftojë Komisionin e Disiplinës, se në rrugë jo zyrtare është vënë në dijeni të faktit se grupi hetimor në përbërje të të cilit ishte dhe \*\*\*\*\*\*, është ndaluar nga policia Greke në Janinë, pa ditur arsyen.

Duke e konsideruar këtë njoftim si shkak për fillimin e një ecurie disiplinore, Komisioni i Disiplinës, bazuar në pikën 6 të nenit 59, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me vendimin nr. 16763/3, datë 04.07.2016, ka nisur shqyrtimin e rastit dhe për mungesë të informacionit të plotë, ka vendosur pezullimin nga ushtrimi i detyrës të nëpunësit civil \*\*\*\*\*\* (në mungesë).

Ndërkohë, Gjykata e Shkallës së Parë Janinë, me Vendimin nr. 816/2016 prot. datë 05.07.2016, pas shqyrtimit të fakteve dhe provave të dosjes hetimore, ka vendosur lirim të menjëhershëm të anetarëve të grupit hetimor, pa asnjë kusht kufizimi të lirisë së tyre, apo ndonjë masë tjetër sigurie.

Pas kësaj, përmes shkesës nr. 16763/15, datë 05.09.2016, të Komisionit Disiplinor, nëpunësi në fjalë, është njohur me aktet e ecurisë disiplinore dhe është njoftuar se brenda 10 ditëve kalendarike duhet të paraqiste shpjegimet me shkrim rreth kësaj çështje.

Më tej, në datën 09.09.2016 është zhvilluar seanca dëgjimore dhe mbas shqyrtimit të materialeve që përmbante dosja hetimore, si dhe informacionit të ardhur nga Drejtori i Hetimit, Komisioni i Disiplinës del me një vendim të ndërmjetëm, nr. 16763/22, datë 13.09.2016, përmes të cilit është vendosur:

1. *Shfuqizimi i pikës 1, të vendimit të ndërmjetëm, nr. 16763/3 prot., datë 04.07.2016.*
2. *Angazhimin e strukturave përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas Memo-s nr. 16763/20 prot., datë 14.09.2016, për t'ju drejtuar organeve kompetente greke, prokurorisë dhe/ose Gjykatës së Shkallës së parë Janinë, në lidhje me dhënien e një informacioni zyrtar mbi statusin juridik të nëpunësit civil \*\*\*\*\* , në procesin që po zhvillohet dhe po ndiqet prej tyre.*
3. *Vijimësinë e ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunësit civil \*\*\*\*\* , pasi për KD është e nevojshme njohja me informacionin e kërkuar në pikën 2 të këtij vendimi.....*

E njëjta përmbajtje e vendimit është edhe për tre punonjësit e tjerë, të cilët janë përfshirë në këtë ecuri disiplinore.

Duke qenë se, në këtë fazë të hetimit administrativ, ndodhemi përpara rrethanave dhe fakteve si më poshtë:

- Vendimi i Ndërmjetëm nr. 16763/22, datë 13.09.2016, ka shfuqizuar pikën e parë të Vendimit të Ndërmjetëm nr. 16763/3 prot., datë 04.07.2016, me të cilin ishte vendosur pezullimi i ushtrimit të detyrës të nëpunësit civil \*\*\*\*\*. Kjo situatë e rikthen punonjësin në fjalë në detyrën e tij funksionale dhe i njeh të gjitha të drejtat që kanë lidhje me pozicionin e punës në vijim.
- Shkak për fillimin e këtij hetimi administrativ nga Komisioneri është bërë pezullimi i tij dhe me rikthimin në detyrë të nëpunësit civil tejkalohej edhe disa parregullsi të konstatuara në marrjen e Vendimit të Ndërmjetëm nr. 16763/3 prot., datë 04.07.2016.
- Komisioni Disiplinor kërkon të thellojë hetimin administrativ pasi me materialet që përmbante dosja hetimore nuk mund të dalë me një vendim përfundimtar. Kjo kërkesë e komisionit gjen mbështetje ligjore, pasi organi disiplinor përpara marrjes së vendimit përfundimtar duhet të hetojë kryesisht të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e ngjarjes të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit.
- Është në kompetencë të organit disiplinor përcaktimi i llojit, qëllimit, shtrirja e hetimit administrativ, si dhe vlerësimi nëse një fakt apo një rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.
- Zgjatja e këtij procedimi disiplinor nuk prek të drejtat legjitime të nëpunësit civil të cilat mbrohen nga aktet ligjore në fuqi.

Komisioneri, vlerëson se duhet të pezullohet procesi i verifikimit të informacionit, për këtë rast, deri në përfundim të procedurës disiplinore të nisur ndaj nëpunësit civil \*\*\*\*\*. Pas përfundimit të kësaj procedure disiplinore, Komisionerit i krijohet mundësia për të verifikuar ligjshmërinë e të gjitha veprimeve administrative të kryera nga organi disiplinor.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 66 dhe 77 e vijues të ligjit nr.44/2016, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe

Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Të pezullohet procesi i verifikimit të informacionit të ardhur për rastin e nëpunësit civil \*\*\*\*\* , deri në momentin e përfundimit të procesit disiplinor dhe nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
2. Menjëherë pas përfundimit të procesit disiplinor, organi përgjegjës ka detyrimin të njoftojë Komisionerin për mbylljen e këtij procesi dhe të dërgojë të gjitha aktet administrative të cilat materializojnë procedurën e ndjekur në këtë rast.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**